



**BASHKIA**  
**TIRANË**  
**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DREJTORIA E KONVIKTEVE TË SHKOLLAVE TË MESME**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

Për: **“RAFIN COMPANY“ shpk**

**Adresa:** TIRANE Njësia Bashkiake nr. 5, rruga "Gjik Kuqali", godinë banimi 6-8 kate dhe 2 kate nëntokë, kati 1, apartamenti nr.4, seksioni 2, pallati "C & S".

Procedura e prokurimit: **“E HAPUR” - prokurim me mjete elektronike Pune.**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-64540-07-07-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Mirëmbajtje e objekteve ndërtimore për Konviktet e Shkollave të Mesme për vitin 2020”.**

Fondi limit: **13.662.890 (trembëdhjetëmilion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dymijë e tetëqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh.**

Kohëzgjatja e kontratës: **60 (gjashtëdhjetë) ditë** mbas lidhjes së kontratës.

*Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Datë 13 Korrik 2020, Nr. 42.***

*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomike më e favorshme*

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. “RAFIN COMPANY“ shpk** numri i NIPT-it :**L52125110A**

Vlera ofertës: **13,542,785** (trembëdhjetë milion e pesëqind e dyzetë e dy mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë); **Lekë pa Tvsh.**

**2. “EURONDERTIMI 2000” shpk** numri i NIPT-it : **K020030010**

Vlera ofertës: **8,751,768** (tetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë e shtatëqind e

gjashtëdhjetë e tetë); **Lekë pa Tvsh.**

**3. “ELDA-VL” shpk numri i NIPT-it : K67106202W**

Vlera ofertes: **nuk ka vlerë ofertë**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- |                                    |                                     |
|------------------------------------|-------------------------------------|
| <b>1. “EURONDERTIMI 2000” shpk</b> | numri i NIPT-it : <b>K02003001O</b> |
| <b>2. “ELDA-VL” shpk</b>           | numri i NIPT-it : <b>K67106202W</b> |

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- |  |             |
|--|-------------|
| <b>1. Operatori ekonomik “EURONDERTIMI 2000” shpk<br/>K02003001O</b> | <b>NUIS</b> |
|--|-------------|

**1.1 Në dokumentat e tenderit, “Kriteret e veçanta për kualifikim”, Pika 2.3.6 e “Kapaciteti teknik” është përcaktuar si më poshtë:**

*“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar për periudhën Janar 2020 - Qershor 2020, si staf teknik punonjës, të pajisur me certifikata të sigurimit teknik nga institucione të akredituara ISHTI (ish-IQT) ose diploma/certifikata nga institucionet e arsimit profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”, kontratë pune të vlefshme dhe të figurojë në listëpagesa, si më poshtë vijon;*

- 10 (dhjetë) punonjës bojaxhi
- 1 (një) teknik ndertimi
- 1 (një) punonjës hidroizolues
- 1 (një) punonjës elektrikist
- 2 (dy) punonjës pllakashtrues
- 2 (dy) punonjës muratorë
- 1 (një) punonjës hidraulik
- 5 (pesë) specialist ndertimi

*Për punonjesit teknik si më sipër, të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, certifikatat përkatëse dhe listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2020 - Qershor 2020.”*

Ky operator ekonomik nuk e plotëson këtë kriter, pasi nuk plotëson numrin e kërkuar të punonjësve me profesionin bojaxhi sepse nga 10 (dhjete) bojaxhi të kërkuar, ka paraqitur dokumentacion vetëm për 3 (tre) punonjes bojaxhi (Adi Hasa, Sokol Saraçi dhe Lulzim Ibra).

**1.2 Në dokumentat e tenderit, “Kriteret e veçanta për kualifikim”, Pika 2.3.9 e “Kapaciteti teknik” është përcaktuar, si më poshtë:**

*“Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane ose*

*të ketë kontratë me një pikë grumbullimi të mbetjeve inerte.*

*Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr 10137, date 11.05.2009 “Per disa ndyshime ne legjislacionin ne fuqi per licensat,autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise”)Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25. ”*

Ky operator ekonomik nuk e ploteson këtë kriter, pasi nuk ka paraqitur licensën e kërkuar (QKL) Kodi III.2.B.

**1.3 Në dokumentat e tenderit, “Kriteret e veçanta për kualifikim”, Pika 2.3.10 e “Kapaciteti teknik” është përcaktuar si më poshtë:**

“Për materialet (elektrike, hidraulike, hidrosanitare, pllaka, ndriçues Led, hidroizolues AB,bojrat,operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit.”

Ky operator ekonomik nuk e ploteson këtë kriter, pasi nuk ka paraqitur asnjë autorizim prodhuesi apo distributori për materialet (elektrike, hidraulike, hidrosanitare, pllaka, ndriçues Led, hidroizolues AB,bojra.

**1.4 Në dokumentat e tenderit, “Kriteret e veçanta për kualifikim”, Pika 2.3.11 e “Kapaciteti teknik” është përcaktuar si më poshtë:**

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për materialet e kerkuara me siper. (të përkthyer në shqip e noterizuara).”

Ky operator ekonomik nuk e ploteson këtë kriter, pasi nuk ka paraqitur asnjë katalog apo fragment katalogu ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për materialet e kerkuara me siper. (të përkthyer në shqip e te noterizuara).

**1.5 Në dokumentat e tenderit, “Kriteret e veçanta për kualifikim”, Pika 2.3.12 e “Kapaciteti teknik” është përcaktuar si më poshtë:**

”Operatori ekonomik duhet të paraqesë për materialin bojë, çertifikatë ECO, që boja hidroplastike është bojë ekologjike, si dhe raportet e testimi, nga laboratorë testues të çertifikuar me ISO 17025:2005, ose ekuivalente nga institucione kombëtarë ose ndërkombëtare të akreditimit, me qëllim përmbushjen standarteve të dhëna në shtojcën e specifikimeve teknike.”

Ky operator ekonomik nuk e ploteson këtë kriter, pasi për materialin bojë nuk ka paraqitur çertifikatën ECO që boja hidroplastike është bojë ekologjike.

Pra sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik “**EURONDERTIMI 2000**” shpk në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

## 2. Operatori ekonomik “ELDA-VL” shpk

**NUIS K67106202W**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik “**ELDA-VL**” shpk konstatoi se ky Operator Ekonomik, **nuk ka paraqitur oferte ekonomike** sipas shtojces 1 dhe preventivit, si dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për plotësimin e kërkesave për kualifikim.

Pra sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë**.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik “**RAFIN COMPANY**” SHPK, me adresë: Njësia Bashkiake nr. 5, rruga "Gjik Kuqali", godinë banimi 6-8 kate dhe 2 kate nëntokë, kati 1, apartamenti nr.4, seksioni 2, pallati "C & S", Tiranë se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **13,542,785 (trembëdhjetë milion e pesëqind e dyzetë e dy mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë); Lekë pa Tvsh**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme, Adresa: Rruga “Jeronim De Rada”, Konvikti i Ekonomikut, Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, procedura do të anulohet pasi nuk ka ofertues vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **19.08.2020**.

**Ankesa:** Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi në mbështetje të nenit 63 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, nuk është paraqitur asnjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktor në lidhje me këtë procedurë prokurimi.